

Po pastaj?

Nga Elodie Hervier

Gjyshja dhe gjyshi kanë tre fëmijë, që kanë secili fëmijët e vet: nipër e mbesa. Vajza e madhe, Izabela në vitet e shkuara, ka bërë gjithmonë çmos që të organizojë përvjetorin e tyre të martesës. Tani janë fëmijët e Izabelës që e shohin këtë si detyrë që duhet ta çojnë më tej, të përmbushin traditën që ajo ka krijuar. Më e madhja, Anë-Sofia, e ka ndarë mendjen ta organizojë vetë 60 vjetorin e martesës së gjyshërve. Ajo e ka marrë gjithë situatën në dorë. Kushërinjtë e saj nuk e mendojnë si ajo.

Personazhet:

Anë-Sofia: njeriu kryesor i organizimit të festës. Prindërit e saj janë Izabela dhe Pieri. Motra e saj quhet Sara. Kushërinjtë janë Poli, Luka dhe Kamila.

Poli: Kushëri i parë i Anë-Sofisë dhe Sarës. Edhe kushëri me Kamilën. Ka vëlla Lukën. I kundërvihet gjithmonë të atit. Është vegan.

Kamila: Kushërirë me Anë-Sofinë e Sarën, po edhe me Polin e Lukën. Kamila është mikeshë e afërt me Polin. Emri “Kamilë” në frëngjisht përdoret për të dyja gjinitë, ndaj personazhi mund të jetë i secilës gjini. (në shqip, nëse zgjidhet mashkull, emri mund të ndryshohet)

Sara: Motra e vogël e Anë-Sofisë, është 17 vjeç.

Luka: Vëllai i madh i Polit. Kushëri me Kamilën dhe me Anë-Sofinë e Sarën.

Magdalena: Gruaja e Lukës, me origjinë greke. Janë njohur kur ishin studentë dhe tani jetojnë së bashku në Itali.

Pieri: Burri Izabelës, babai i Anë-Sofisë, Sarës dhe i fëmijës së tyre të tretë Tibosë.

Kamarieri/ja: mashkull ose femër

Ngjarja ndodh në një restorant, ku Anë-Sofia ka mbledhur kushërinjtë, për të parë si mund ta ndihmojnë që të organizojë darkën festive të përvjetorit.

Atmosfera restoranti – rreth një tryeze janë ulur: Anë-Sofia, Luka, Poli, Kamila, Sara, Magdalena.

Vjen kamerieri/ja.

Kamerieri/ja: Kiri¹ ishte për...?

Anë-Sofia: Mua.

Kamerieri/ja: Dhe birrat...?

Anë-Sofia: Një aty, një për Kamilën dhe një këtu, më duket? Jotja ishte birra?

¹ Pije e bërë me verë të bardhë ose shampanjë dhe krem rrushi të zi mali

Luka: Pol, jotja ishte birra?

Poli: Po.

Anë-Sofia: Ah, e gjetëm... dhe një, atje! Mirë! Pra, ta ngremë për nënën me gjyshin dhe mbi të gjitha, ju faleminderit që po më ndihmoni me organizimin.

Të gjithë në tavolinë përplasën gotat – dëgjojmë dy prej personazheve që flasin me njëri-tjetrin, duke treguar të rejtat e fundit. Në fund, dëgjojmë Anë-Sofinë në sfond, në krahun tjetër të tryezës, që flet për përgatitjet: "Pra, duhet të zgjidhim pagesat e blerjeve, sa kohë duhet që të gatuhet mishi, datën e kemi ndarë. Duhet të ndjekim... Po, duhet të blejmë edhe pijet, e kam ndarë çfarë na duhet dhe kam shkruar ç'është blerë deri tani."

Vëmendja shkon te Kamila e Poli, që janë ulur pranë dhe po flasin me njëri-tjetrin.

Poli: Darkë për të organizuar një darkë. Kjo është çmendur, ë?

Kamila: E po... ti e di që vdes të stresohet.

Poli: Po, këtë, me sa duket, e ka pasionin e saj më të madh. Pra... a ka ndonjë gjë që duhet ta di?

Kamila: Si? Nuk i ke dëgjuar mesazhet e saj zanore?

Poli: Hëm...

Kamila: Po, e di... po ka shumë detyra dhe nuk t'i përmbledh dot me dy fjalë.

Poli: S'ka gjë. I dëgjoj me dyfishin e shpejtësisë.

Kamila: Ha ha ha, ç'do na kapë me presh në dorë! Uli pak zërin, të paktën.

Në vijim disa mesazhe zanore. Poli i luan, por i dëgjon me ndërprerje. Ca i përshpejton, ca i ndërpret dhe dëgjohet edhe tingulli i aplikacionit në fund të mesazheve.

Tekstet këtu mund të shkurtohen dhe janë sugjerime për ritmin, ndërprerjen e përzierjen e mesazheve.

Mesazhi Nr. 1 - Anë-Sofia: *(me një zë nga ato të video-influencuesve)* Hej, kalamaja! Ç'kemi kushërinj! Sivjet nëna me gjyshin festojnë përvjetorin e gjashtëdhjetë të martesës dhe e dimë që kjo është ngjarje e rëndësishme... Siç ndodh në të tilla raste, duhet pjesëmarrja e të gjithëve për organizimin. Ha ha ha, le të le të themi që unë jam koka e këtij komiteti organizues, ha ha ha. Seriozisht, tani, që të kënaqen të gjithë me gatimin dhe që të ndihmojmë njëri-tjetrin me përgatitjet e me vendin se ku do të të flenë 3 fëmijët e nënës e gjyshit, me gjithë burra e gra, plus 8 nipër e mbesa, po edhe brezi i ri prej 2 stërnipërisht të moshave të ndryshme...

Mesazhi Nr. 2 - Sara: Ha ha ha! Hej, që të gjithë, faleminderit Anë-So! Ky grup është i paparë. Pra, unë kam detyrë të bëj dadon, se siç tha ime motër, tani kemi të vegjël në familje. Mund të ndihmoj edhe me gatimin pasdite, nëse ka nevojë. Në rregull! Mezi po pres t'ju takoj.

Mesazhi Nr. 3 - Pieri: Unë dhe Tibo kemi për detyrë tortën. Çfarë torte doni?

Mesazhi Nr. 4 - Kamila: *Bonjour!* Sigurisht që do të jem për ditën e madhe, veç në mos zgjidhni fundjavën e 13 marsit. Gjithsesi, ia kam dhënë Datat Anë-So...

Mesazhi Nr. 5 - Pieri: Hej, s'na tha njeri si t'ia bëjmë me tortën.

Mesazhi Nr. 6 - Kamila: Në rregull. Sa për debatin vegjetarian, them se jam dakord: ia vlen të provojmë një gjë të re në vend të proshutës me majonezë. Që fëmijë s'më ka pëlqyer...

Mesazhi Nr. 7 - Sara: Po, ide e mirë të bëjmë disa ndryshime, po, hej, nëse ka nga ata që ua ka qejfi roston, mund t'i rrimë nga pak edhe traditës. Dhe meqë Anë-So është ajo që...

Mesazhi Nr. 8 - Sara prapë: Edhe pse, nëse do të më duhet të zgjidhja vetëm një lloj mishi, do të zgjidhja mish rose.

Mesazhi Nr. 9 - Pieri: Më duket ide e mirë. Po dua që njëri të më thotë ç'lloj torte doni?

Zhurma restoranti, Kamerieri/ja po merr porositë.

Kamerieri/ja: Dhe për ju, zotëri?

Poli: Nuk ka asgjë vegjetariane në meny?

Kamerieri/ja: Ka dy mundësi për vegjetarianët, ka edhe peshk.

Poli: Po, por nëse mbetet cofëtinë, nuk është vegjetariane... makaronat me shpargull bëhen me vaj ulliri, apo jo?

Kamerieri/ja: Hëm... Do të doja të thosha po?

Poli: E po, këtu s'është çështja ç'do të doje të thoshe... jam vegan, ndaj nuk dua asnjë nënprodukt shtazor.

Kamerieri/ja: Mirë, do kontrolloj para se ta jap porosinë.

Poli: Përndryshe, më sill vetëm një pjatë patate të skuqura...

Anë-Sofia (*nga krahu tjetër i tavolinës*): Pra, edhe ne do të na e nxish me mishin. Ky muhabet s'do mbarojë kurrë.

Luka (*e ndërpret Anë-Sofinë*): Në fakt, edhe unë e Magdalena jemi vegjetarianë. Magdalena ka me qindra receta greke...

Vëmendja kalon sërish te biseda mes Kamilës e Polit.

Poli: (*me zë të ulët*) Po kjo gjëja nuk mbaron. Të vetmet që mund t'i çoj deri në fund, janë ato të xhaxhait që janë nga 7 sekonda.

Kamila: Duhet të dish vetëm që donte t'i ftone të gjithë dhe që kanë zgjedhur një datë, kur edhe yt atë është i lirë, se ishte e vetmja datë kur mund të vinin të gjithë.

Zëri i Lukës bëhet sërish më i fortë dhe Kamila me Polin e ndalin bisedën. Vëmendja kthehet në qendër të tavolinës.

Luka: U bë shumë kohë, në fakt, që unë e Poli jemi vegjetarianë. Edhe ime shoqe. Do të ishte bukur që këtë herë familja të njihej me recetat tona. Gjithmonë siç doni ju bëhet.

Anë-Sofia: Po, po këtë duhet ta organizojë dikush. Njerëzve u pëlqen të jenë të organizuar.

Magdalena: Anë-Sofi, mund t'i blejmë ne gjërat. E planifikojmë ne.

Anë-Sofia: Shumë e sjellshme, po nuk më shqetëson vetëm blerja. Duhet të ketë ushqim për të gjithë dhe ca njerëzve u pëlqen që të ketë gjithmonë mish. Nuk do të doja të rrezikoj.

Kamila: Mbase bëjmë një zonë vegjetariane?

Magdalena: Shiko, nuk po e mendonim kështu. Do të jetë lëmsh me gjithë këto pjata të ndryshme bashkë, po... ashtu shkon gjithmonë.

Luka: Më duket e pabesueshme që nuk u ndryshuaka menyuja.

Kamerieri/ja: Për kë ishte hamburgeri i pulës?

Pas disa pyetjesh, pjatat shtrohen në tryezë.

Sara (*duke u përpjekur ta ndryshojë atmosferën*): Pra, *bon appetit* që të gjithëve.

Luka: Edhe atyre që nuk hanë mish?

Anë-Sofia: Po, a vazhdojmë tani? Kush i pret të ftuarit? Kamila dhe Poli, meqë nuk jeni në skuadrën e blerjeve ose të gatimit, mendova ta bëni ju?

Poli: Hëm, jo....

Kamila: Do të ishte më mirë sikur unë e Poli të ndihmonin skuadrën e gatimit vegjetarian.

Anë-Sofia: Po. Pra, e keni ndarë mendjen të mos bëni asgjë nga ato që ju kërkua?

Poli: Ashtu si ti ke ndarë mendjen të mos marrësh parasysh asgjë nga ato që ne kemi kërkuar.

Anë-Sofia: Sapo thashë që mund të keni gatime vegjetariane.

Poli: E kam fjalën për faktin që ke ftuar tim atë, kur ta bëra plotësisht të qartë të zgjidhje një fundjavë, kur ai nuk ishte i lirë.

Sara: Zgjodhëm datën kur mund të vinin të gjithë dhe është logjike.

Poli: Logjike për ty.

Anë-Sofia: Ç't'i thoshim nëse nuk do të vinte dot?

Poli: Që sjellja e tij në prani të të tjerëve është e padurueshme? T'i thoshit se ju ka ardhur në majë të hundës, që nuk ndihmon kurrë njeri. Se nuk e duroni dot më që të gjithë i lejojnë të bëjë si të dojë. Që është i pasjellshëm me njerëzit. Harbut me gratë. Dhe se shumica e gjërave që bën, u nxin faqen djemve të tij. Mund t'i thoshit, për shembull, se e kemi duruar ca si shumë. Se që të gjithë e lënë të kalojë, po ja që gjithmonë ai krijon situata muti dhe se sivjet do të ishte mirë të mos kishte një dajë të padurueshëm në krahun tjetër të tavolinës. Ju e dini si është, mos bëni sikur nuk e dini për çfarë po flas.

Sara: E vërtetë është... kujtoj që e kam pasur shumë frikë nga mënyra si ju bërtiste juve.

Anë-Sofia: Po, mirë... e tani? Në fund të fundit, ka ndodhur kur ishim fëmijë. Nuk do ta ndryshojmë 21 marsin. E kemi shkruar në ftesa, kemi rezervuar edhe sallën. Përvjetori i martesës së nënës e gjyshit bëhet më 21 mars 2020 dhe nuk do ta ndërrojmë për një çikërrimë. Sidomos që të mos vijë një prej fëmijëve të tyre. Nuk është ndonjë ngjarje çfarëdo, apo jo?

Poli: Dhe ç'duhet të bëj unë gjithë festën?

Anë-Sofia: Që të gjithë do të jenë të lumtur të të kenë rrotull. S'do të jeni veç ju të dy. Kushdo duhet të dalë nga flluska e vetes. Njerëzit duhet të çlirohen. Kështu janë gjërat. Përvjetori i martesës është më 17 mars dhe ne do ta festojmë më 21. Kjo është data dhe s'ka më diskutime. Ajo që ndodh me tët atë është, thjesht, jeta dhe është ashtu siç është. Çdo familje ka hallet e saj. Kështu është e gjithë bota dhe nuk besoj se do të ndryshojë ndonjëherë.